



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701404/2

Tiranë \_\_. \_\_. 2017

**Lënda:** *Rekomandohet marrja e masave për revokimin dhe konstatimin si të pavlefshëm të Urdhërit Nr.79 datë 24.02.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme për largimin nga puna të Znj. Arshela Arapi, si dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.*

**Drejtuar :** Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme  
z. Gazmend Barbullushi

**Për dijeni:** Ministrin të Punëve të Jashtme  
Z. Ditmir BUSHATI

**TIRANË**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja Arshela Arapi në të cilën ankohet ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme për largim të padrejtë nga puna, dhe moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Konkretisht, ankuesja pretendon se prej vitesh ka qenë në Shërbimin Diplomatik në Ambasadën tonë në Paris, pas ristrukturimit është larguar nga puna dhe Shërbimi Diplomatik në Ministri, me vendimin nr 79 datë 24.2.2014 "për kalimin në listë pritje" të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme . Ndodhur në këto kushtet ankuesja i është drejtuar gjykatës me padi:

- Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ vendimi nr 79 datë 24.2.2014 "për kalimin në listë pritje" të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
- Detyrimin e palës së paditur MPJ, për të kthyer paditësen në vendin e mëparshëm të punës, në pozicionin Sekretare e Parë në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Paris.
- Detyrimin e palës së paditur MPJ, për ti paguar paditëses pagën mujore që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e rikthimit në vendin e punës.
- Detyrimin e palës së paditur MPJ, për pagimin e sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe njohjen e vjetërsisë në punë të paditëses, deri në rikthimin në vendin e punës.
- Detyrimin e palës së paditur MPJ, për të paguar shpenzimet gjyqësore.

Me vendim Nr.1780 (258) datë 15.07.2015 Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë vendimin e formës së prerë, në të cilën është vendosur : ***“Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ vendimi nr 79 datë 24.2.2014 "për kalimin në listë pritje" të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Detyrimin e***

*palës së paditur MPJ, për të kthyer paditësen në vendin e mëparshëm të punës, ose në pamundësi në një vend tjetër të barazvlefshëm me pozicionin e punës të ushtruar nga paditësja në momentin e lirit. Detyrimin e palës së paditur MPJ, për ti paguar paditëses pagën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në datën e rikthimit në vendin e punës”.*

Edhe pse Ministria e Punëve të Jashtme ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit nr. 1780 (258) datë 15.07.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 00-2017-893 datë 12.04.2017 vendosi **“ Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Ministria e Punëve të Jashtme kundër vendimit 1780 (258) datë 15.07.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit”**

Sa më sipër, ankuesja sqaron se ka paraqitur kërkesa të vazhdueshme me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të mësipërm, por nuk është ndërmarrë asnjë masë për zgjidhjen e këtij problemi. Për sa më sipër, duke mos gjetur një zgjidhje ligjore të ankesës së saj, Znj. Arapi, ka kërkuar edhe ndihmën e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim ndërmjetësimin pranë jush për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese.

I nderuar z.Barbullushi,

Në vijim të Urdhërit të mësipërm për largimin nga puna të znj.Arapi Institucioni i Avokatit të Popullit pasi studioi me vëmendje pretendimet e ngritura nga ankuesja dhe duke u bazuar në gjithë dokumentacionin përkatës të paraqitur nga ana e saj, si dhe referuar vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ju parashtron objeksionet e mëposhtme lidhur me shkeljet e konstatuara në veprimet e ndjekuara nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme për sa më poshtë vijon:

### **Kuadri ligjor që garanton zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.**

**Së pari:** E drejta për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore e individit, është e garantuar në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se : “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, në nenin 6 të saj sanksionon se : “Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila të vendosë qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij...”.

**Së dyti:** E drejta për një proces të rregullt ligjor, në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qëndron vetëm tek veprimtaria e organeve gjyqësore, pasi ajo fillon dhe nuk mund të përjashtohet edhe në veprimtarinë administrative të organeve të administratës publike me rastin e respektimit të detyrimit të sanksionuar në nenin 142, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se : “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

Pavarësisht këtyre rregullimeve, përsëri situata paraqitet problematike. Referuar misionit për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në një numër jo të vogël të rasteve të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk respektohen me rigozitet prej debitorit ose personave të tretë të cilët sipas urdhërit të ekzekutimit apo ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Nëpërmjet këtij Rekomandimi, synojmë sensibilizimin për situatën aktuale në të cilën ndodhet sot procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv, si dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, sikurse parashikohet në nenin 9 të K.Pr.A., prej institucioneve dhe organeve debitoare apo të treta në procesin e ekzekutimit. Problematikat e hasura për të përfunduar ekzekutimin e gjithë vendimeve gjyqësore të formës së prerë (titujve ekzekutiv) të dhëna në vite, sipas të cilëve është vendosur detyrimi i institucioneve buxhetore të paguajnë detyrime në të holla apo të kryejnë përmbushjen e një veprimi të caktuar ndaj subjekteve të ndryshëm gjyqfitues, nuk është në nivelin e angazhimit të marrë nga qeveria. Pra, problemi i mosekzekutimit të titujve ekzekutiv mbetet edhe sot një nga problemet e përsëritura me të cilin është ndeshur dhe ndeshet Institucioni i Avokatit të Popullit.

**Në këto kushte është i nevojshëm ndërgjegjësimi i administratës publike lidhur me detyrimet e saj gjatë kryerjes së funksioneve të njohura me ligj, në zbatim të vendimeve të gjykatave, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor i cili bën të mundur përfundimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë ashtu siç duhet, efektiv dhe brenda një afati të arsyeshëm. Po kështu, në kundërshtim me detyrimin e vendosur nga gjykata, në disa raste, titullarët e institucioneve buxhetore debitoare, kanë mbajtur qëndrim të papranueshëm në përmbushje të detyrimit për pagimin e pagave në favor të gjyqfituesve.**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit vazhdimisht janë paraqitur ankesa, për moszbatim të legjislacionit dhe procedurave për shërbimin civil, apo edhe për zbatimin e vendimeve gjyqësore për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës. Për këtë çështje, por edhe për problematika të tjera të marrëdhënieve juridike të punës nga organet e tjera të administratës publike, që nuk janë pjesë e shërbimit civil, bazuar në ankesat/kërkesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit, është përgatitur edhe një vlerësim i cili i është përcjellë Departamentit të Administratës Publike. Sipas këtij vlerësimi, bazuar në trajtimin e ankesave të paraqitura pranë institucionit, është konstatuar se:

- a. Shkak për largimet nga puna, si për personat që kishin statusin e nëpunësit civil ashtu edhe për ata që trajtoheshin me Kod Pune, në shumicën e rasteve kanë qënë reformat institucionale, ristrukturimi apo edhe motivet politike për t'i lënë vendin personave të tjerë;
- b. Në shumicën e rasteve, kur zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, nuk është respektuar ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor;
- c. Ka mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës e për të cilën punëdhënësi është i detyruar të zbatojë atë, në rastet e punëmarrësve me status të nëpunësit civil;

Bazuar në problematikat e sipërcituara është vlerësuar se është e nevojshme që:

1. Të zbatohen standartet e vendosura nga kuadri ligjor ekzistues që garanton marrëdhëniet e punës, nga ana e administratës publike të të dyja niveleve.

2. Duhet për çdo rast të nxirret e përgjegjësia e drejtuesve të institucioneve (dëmi jashtëkontraktor) të cilët janë shkaktarët e situatave të paligjshmërisë në trajtimin e marrëdhënieve të punës dhe që me veprimet e tyre të parregullta dhe të pabazuara rrisin faturën financiare të detyrimit të shtetit ndaj gjyqfituesve.

Në bazë të nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”, si dhe bazuar në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, :

### **REKOMANDOJMË:**

*1.Ekzekutimin brenda afateve ligjore të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me rikthimin në detyrë të ish punonjësës znj.Arshela Arapi, si dhe pagesat e efekteve financiare rast pas rasti.*

*2.Marrjen e masave për zbatimin e drejtë dhe respektimin e legjislacionit përkatës si Kodit të Punës dhe Ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, për çdo punonjës të Administratës Publike me qëllim shmangien dhe mospërsëritjen e rasteve abuzive në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës mes palëve.*

Lidhur me qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.4.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar të vihemi në dijeni brenda afatit ligjor.

*Duke shpresuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,*

**Me respekt**

**Arben SHKËMBI**